

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

“PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, PROCEDURAVE DHE KRITEREVE TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PËR NJË JETESË TË PAVARUR PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave propozohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 6, të Ligjit Nr. 93/2014, “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

Qëllimi i këtij projektvendimi është të përcaktojë rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të shërbimeve për një jetesë të pavarur për personat me aftësi të kufizuar.

Objektivi kryesor që synohet është përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuar dhe bashkërendimi i shërbimeve sipas konceptit të jetesës së pavarur për rritjen e gjithëpërfshirjes dhe integritimit social.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektvendimi hartohet në përputhje me programin politik qeverisës 2021-2025, objektivin “Mirëqenie për të gjithë”, Konventën e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar”, ratifikuar nga vendi ynë në vitin 2013. Gjithashtu është në linjë me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Planin Kombëtar për Afësinë e Kufizuar 2021-2025.

Projektvendimi është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për katër mujorin e tretë të vitit 2022.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij projektvendimi do të mundësojë bashkërendimin e shërbimeve të ofruara për jetesën e pavarur të personave me aftësi të kufizuar. Shërbimet e jetesës së pavarur sipas Nenit 5, Pika e, të Ligjit Nr. 93/2014 mbështesin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës.

Shërbimet për jetesë të pavarur, sipas këtij projektvendimi do të krijojnë një kuadër të përgjithshëm kombëtar, për përshtatjen graduale të shërbimeve që ofrohen nga çdo subjekt, që ofron të mira dhe shërbime për publikun, publik apo privat, duke përfshirë institucionet e pavarura, institucionet e administratës shtetërore, bashkitë dhe qarqet.

Në përputhje me Ligjin Nr. 93/2014 në shërbimet për jetesë të pavarur përfshihen: asistencë personale, pajisjet e mjetet teknike mbështetëse, shërbimet e aksesueshmërisë, përfshirë transportin, përshtatja e arsyeshme dhe, atëherë kur është e nevojshme, vendimmartja e mbështetur.

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve të ofrimit të shërbimeve për një jetesë të pavarur për personat me aftësi të kufizuar”.

Asistenca/ndihmesa personale, shërbimet e aksesueshmërisë dhe vendimarrja e mbështetur janë rregulluar gjithashtu me një kuadër fillestar ligjor, në zbatim të parimeve të Ligjit Nr. 93/2014. Projektvendimi përfshin shërbimet sociale, shëndetësore, arsimore, mjete ndihmëse apo teknologjike, të komunikimit në braille dhe dëgjim, që ofrohen aktualisht duke mundësuar realizimin e të drejtave të PAK.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi propozohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 6, të Ligjit Nr. 93/2014, "Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara".

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk ka përputhshmëri me *Acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi përbëhet nga pika 1-ku përcaktohen rregullat, procedurat dhe kriteret për ofrimin e shërbimeve të jetësës së pavarur, sipas teksit bashkëlidhur këtij projektvendimi.

Në pikën 2 përcaktohen institucionet që ngarkohen për zbatimin e tij.

Teksti bashkëlidhur përmban në Kreun I dhe II, përkufizimet dhe rregulla të përgjithshme për ofrimin e shërbimeve të jetësës së pavarur nga institucionet publike apo jopublikë që ofron të mira dhe shërbime për publikun, duke përfshirë institucionet e pavarura, institucionet e administratës shtetërore, bashkitë dhe qarqet.

Institucionet të cilat ofrojnë shërbime ekzistuese për PAK duhet të garantojnë lehtësi dhe akses për shërbime në funksion të jetësës së pavarur për të garantuar pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës, sipas fushë-veprimtarisë së tyre. i) Strehim; ii) Transport; iii) Shëndetësi; iv) Kujdes social; v) Arsimit dhe vi) Punësim.

Shërbimet synojnë të trajtojnë nevojat e individit me aftësi të kufizuar, duke respektuar të drejtat dhe dëshirat e tyre në mënyrë gjithëpërfshirëse. Shërbime për jetesë të pavarur që ofrohen nga subjektet publike dhe private është parashikuar të koordinohen nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashki/qarqe, sipas planit individual të mbështetjes (PIM), Aneksi nr. 1.

Kriteret për ofrimin e shërbimeve të jetësës së pavarur që ofrohen për Personat me Aftësi të Kufizuar janë gjithëpërfshirëse në frymën e KDPAK me aksesueshmëri dhe mjete ndihmëse.

Në Projektvendim jepet procedura për përfitimin e shërbimeve të përshtatjeve të arsyeshme në të gjitha fushat e përmendura, duke marrë parasysh specifikat e vecanta të çdo fushe dhe kërkesave të subjekteve

Në Kreun V është parashikuar dhe mënyra e ankimimit për rastet e mosofrimit të shërbimeve të jetësës së pavarur, çdo person me aftësi të kufizuar dhe informimin për përshtatjen e arsyeshme.

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve të ofrimit të shërbimeve për një jetesë të pavarur për personat me aftësi të kufizuara".

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Projektvendimi është hartuar nga Ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe dërgohet për konsultim të brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Brendshme, Ministria e Transportit dhe Energjetikës dhe Këshillin Konsultativ të Vetqeverisjes Qendrore dhe Vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar me asistencën teknike nga PNUD.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i institucioneve përgjegjëse sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

PROPOZUESI

MINISTRI

OGERTA MANASTIRLIU

